

Prof. Dr. Marenglen Verli, EKONOMIA E KOSOVËS NË VARGONJTË E POLITIKËS JUGOSLLAVE 1945 – 1990, Tiranë, 2000.

Pak kohë më parë doli nga shtypi monografia e historianit nga Tirana Prof. Dr. Marenglen Verlit “*Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*”. Është ky plotësim i një boshllëku të madh në historiografinë shqiptare. Studimi i zhvillimit historik të ekonomisë është i domosdoshëm nëse dëshirohet të arrihet pasqyrimi i plotë i rrjedhave të përgjithshme shoqërore të një vendi. Ky konstatim bëhet edhe më i domosdoshëm në rastin specifik të Kosovës, ku, siç dihet, u ndoq një politikë e veçantë ekonomike nga pushteti qendror i Federatës Jugosllave, të dominuar e të udhëhequr nga serbët, të cilët ndaj popullatës shumicë dhe tokës së Kosovës kishin pretendime dhe qasje të veçantë. Për këtë është plotësisht i vetëdijshëm edhe autori, megjithëqë nuk është nga Kosova. Ai që në parathënie të librit konstaton: “Që nga viti 1913 e deri në ditët tona të gjitha segmentet e elitës politike të Serbisë dhe të Jugosllavisë, pavarësisht nga ngjyrat që kanë pasur në spektrin politik, pavarësisht nëse për momente të ndryshme kanë formuar grupimin në pushtet ose opozitë, ndaj Kosovës dhe banorëve të saj shqiptarë përgjithësisht kanë pasur të njëjtat pikësynime e qëndrime. Objektivi final i Beogradit politik zyrtar e jozyrtar, gjatë gjithë këtij harku kohor dhjetërvjeçar, madje edhe më parë, ka qenë shklobëtarizimi dhe sllavizimi i Kosovës dhe më gjerë i të gjitha viseve shqiptare të aneksuara. Vetëm ndryshimi i përhapjes etnike është konsideruar proces i sigurt për përjetësimin e sundimit në këto vise dhe për realizimin e projektit të vjetër shovinist të Garashanit, “*Naçertanjes*” së vitit 1844. Lidhur me krijimin dhe arritjen e këtyre objektivave që u p[ro]q në vazhdimësi Beogradi të aplikojë, ka qenë

vënia e Kosovës në pozitën e një kolonie dhe trajtimi i shqiptarëve si një popullsi koloniale. Nga një pozitë e tillë kjo krahinë do të duhet të ushqente ekonominë e metropolit me lëndë të para dhe fuqi punëtore me çmim të lirë, duke përbërë vetëm një apendis në kuadër të ekonomisë jugosllave dhe absolutisht jo një njësi të integruar normalisht mbi bazën e mundësive që ofronte gjatë Mbretërisë Jugosllave ekonomia e tregut, ose edhe mbi bazën e mundësive që lejonte një ekonomi e centralizuar sociale me tiparet e ekonomisë së tregut, si ajo e Jugosllavisë së Titos. Pikërisht ky synim i vënë në themel të politikës ekonomike të Serbisë e Jugosllavisë ndaj Kosovës, por edhe ndaj viseve të tjera shqiptare, e cila u konstruktua për të ndihmuar realizimin e objektivit final politiko-nacionalist të shklobëtarizimit, diktoi atë trajtim ekonomik-soial të institucionalizuar përmes të gjithë mekanizmave shtetërorë, që pati në thelb shfrytëzimin dhe denigrimin ekonomik të Kosovës, të viseve të tjera shqiptare dhe kuptohet përgjithësisht të popullsisë shqiptare.

Monografia “*Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*” shqyrton temën sa interesante po aq edhe komplekse e të vështirë të historisë së ekonomisë kosovare, 45 vjetet e pasluftës dhe synon t’i pasqyrojë ecurinë ekonomike të Kosovës, kahet e orientimit dhe përmasat e zhvillimit të saj nëpër etapa, të evidencojë me fakte varësinë e këtyre treguesve nga synimet serbe dhe të argumentojë në këtë kuadër pozitën veçanërisht të diskriminuar të popullsisë etnike shqiptare.

Me qëllim të trajtimit sa më efikas të temës, monografia në pikëpamje strukturore është sipas kritereve të metodës

kronologjike-problematike të prezentimit të materialit. Dy pjesëve kryesore u paraprin kapitulli hyrës i titulluar “*Ekonomia e Kosovës në periudhën para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore*”, ku krijohet ideja e përgjithshme mbi mundësitë poetenciale të Kosovës, mjaft të favorshme për të mbështetur zhvillimin e vrullshëm ekonomik të kësaj krahine. Gjithashtu jepen informacione të bollshme mbi ecurinë e ekonomisë së Kosovës në vitet 1913-1945.

Në kapitullin e parë dhe të dytë i bëhet një vështrim periudhës së pasluftës deri në momentet e shpalljes së Reformës Ekonomike dhe të përfundimit të punimeve të Plenumit të njohur të Brionëve. Këto dy dekada përmbyllin në vija të përgjithshme një periudhë kur Jugosllavia kaloi gradualisht nga rruga socialiste e tipit sovjetik në zhvillimin e vet ekonomiko-shoqëror drejt rrugës së socializmit specifik vetëqeverisës ose siç e quan autori “vetëadministrues”. Në këtë pjesë janë evidencuar me shumë kujdes e saktësi dështimet ekonomike në vitet 1947-1951, dukuritë specifike për Kosovën në dy fazat e zbatimit të sistemit të “vetëadministrimit” të viteve 1947-1957 dhe atë 1957-1965.

Periudha vijuese 25-vjeçare 1966-1990 trajtohet në kapitujt dhe katër. Autori, në mënyrë të veçantë, ndalet me vështrimin e tij në periudhën 15-vjeçare të liberalizimit të sundimit serbo-jugosllav në Kosovë. Ishte kjo kohë e krijimit të disa hapësirave pozitive vetadministruese në qeverinë e Kosovës, që ishin si rezultat i koniukturave të krijuara në rrafshin ndërkombëtar e që reflektoheshin edhe në Jugosllavinë, ku u paraqitën lëkundje çekuilibruese në raportin e forcave. Kjo dukuri ishte më e dukshme në gjysmën e parë të periudhës së përmendur. Në vijim trajtohet dekada e krizës që përfshin Jugosllavinë, përkatësisht fillet e shpërbërjes së saj dhe reflektimet që u vërejtën në Kosovë.

Kapitulli i tretë i titulluar “*Ecuria e Kosovës në vitet 1966-1980*” trajton gjendjen e Kosovës në periudhën përkatëse dhe analizon ecurinë e ekonomisë pas hyrjes në veprim të legjislacionit në ri kushtetues jugosllav. Këtu pasqyrohet struktura e degëve ekonomike, dinamika e ndryshimeve pozitive në favor të degëve finalizuese të prodhimit, specifikat e bujqësisë në kuadër të saj, si dhe rrugët e diskriminimit dhe të shfrytëzimit të ekonomisë kosovare.

“*Ekonomia e Kosovës në periudhën e Krizës Jugosllave të viteve 80*” është titulli i kapitullit të katërt të monografisë, përmes të cilit hidhet dritë mbi problemet e ekonomisë kosovare në periudhën pas vitit 1981, kur reflektimet e rrjedhave politike ishin shumë të dukshme. Këtu pasqyrohet ndikimi i kontradiktave ekonomike midis Kosovës dhe viseve të tjera Jugosllave që çoi edhe në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981. Vihen në dukje edhe projektet dhe përpjekjet për thellimin e varësisë dhe të integritimit të dhunshëm ekonomike të Kosovës në kuadrin republikan dhe federativ.

Monografia përmbillet me kapitullin e pestë të titulluar “*Reflektimi i politikës ekonomike Jugosllave në gjendjen ekonomiko-sociale të popullsisë kosovare gjatë viteve 1947-1999*”. Në këtë pjesë hedhet dritë mbi pasojat e politikës ekonomike të Jugosllavisë dhe tendencat e saj ndaj Kosovës. Përmes raporteve krahasuese Krahinë-Federatë në treguesit kryesorë që përcaktojnë nivelin ekonomik të çdo vendi, sikurse janë prodhimi dhe të ardhurat kombëtare për banor, punësimi i njerëzve dhe papunësia, emigracioni ekonomik, urbanizimi, përhapja dhe zhvillimi i arsimit, shëndetësia, etj., krijohet kështu përfytyrimi real mbi gjendjen e shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën absolute të Kosovës. Monografia mbyllet me nëntitullin “*Ekonomia e Kosovës në vitet e shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë*”, ku afrohen disa të dhëna që hedhin dritë mbi

situatën në të cilën u ndodh ekonomia e Kosovës pas vitit 1990, kur edhe filloi shpërbërja e shpejtë e krijesës artificiale të quajtur Jugosllavi. Në këtë periudhë qarqet drejtuese të Beogradit vepronin jashtë çdo norme ligjore me qëllim të grabitjes dhe të tjetërsimit pronësor të ekonomisë shoqërore kosovare në favor të Serisë dhe të pakicës serbe në Kosovë, duke vazhduar synimet e tyre të vjetra grabitqare dhe duke synuar që atë ekonomi ta bënin krejtësisht të paaftë për të qenë një faktor material që do ta mbështeste aspiratën politike të shqiptarëve për pavarësi dhe për shtet të vetin kombëtar.

Për hartimin e monografisë *“Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave (1945-1990)”*, është nevojitur një punë e gjatë dhe e mundimshme hulumtuese. Janë vjelë të dhënat e nevojshme nga vjetarët statistikorë, vëllimet e ndryshme dokumentare, legjislacioni i kohës si dhe është shfrytëzuar me shkathtësi të lartë literatura relevante e vendit dhe jashtë tij. Është për t’u lavdëruar puna serioze dhe arritja e qëllimit që ecuria ekonomike në Kosovë pas vitit 1945 është vështruar në lidhje të pandashme me ecurinë politike në Jugosllavinë e pas Luftës së Dytë Botërore, mandej procesit në vitet 80-ta i është kushtuar një vëmendje e veçantë dhe meritore, gjithashtu tezave dhe ideve të shumta që paraqiten në monografi, duke u mbështetur me të dhëna të plota statistikore të kombinuara për një periudhë 45-vjeçare dhe, së fundi, është bërë përpjekje për të hapur kritikën ndaj

politikës ekonomike që Jugosllavia ndoqi në Kosovë, natyrisht në dimensionet dhe thellësinë që lejon një studim i këtyre përmasave, duke pasqyruar paralelisht pasojat e kësaj politike mbi ekonominë kosovare dhe në veçanti mbi popullsinë shqiptare të Kosovës e më gjerë.

Monografia e kolegut nga Tirana, padyshim se paraqet një kontribut të rëndësishëm shkencor si dhe do të zbusë mungesën e informacionit të lexuesve në Republikën e Shqipërisë për Kosovën dhe për bënëtorët e saj shqiptarë. Gjithashtu do ta kënaqë kërshërinë e lexuesve të tjerë me shumë të dhëna për çështjen ekonomike të Kosovës për periudhën përkatëse. Duhet përmendur se ky botim është i shoqëruar dhe i begatuar edhe me tabela e grafikone të shumta, me harta dhe aparaturën e nevojshme shkencore, gjëra këto, të cilat pa dyshim se ia shtojnë vlerën reale këtij libri.

Në përfundim të këtij vështrimi do të kisha dhënë një sygjërim të përgjithshëm për këtë botim, por edhe për botimet e tjera të autorëve të jashtëm që shkruajnë për Kosovën, që në foma të ndryshme (recensione, apo konsultimet profesionale), t’i shtojnë kontaktet me studiues vendës, sepse ashtu shmanget ndonjë lëshim në emrat e vendeve dhe botimet e tyre, në këtë mënyrë, bëhet edhe më i çmuar për lexuesin kosovar.

Dr. Haki Kasumi,
Instituti i Historisë
Prishtinë